



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01. Nr. 006-2732
KLINË, 29.4.2016

PROCESVERBAL

I SEANCËS SË KATËRT TË KK, MBAJTUR, MË 29.4.2016, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, Kryesuesi i Komunës, Dr. Haxhi Ibishi, Nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit (25), drejtorë të drejtorive, Komandanti i Policisë, Rexhë Berisha, Zyra Ligjore, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Ibishi, i cili fillimisht i falënderoj pjesëmarrësit për përfaqësim në këtë seancë të KK, i cili në vazhdim hapi debatin rreth rendit të ditës.

Fadil Gashi: “Meqë jemi në muajin prill, në emër edhe të LDK-së, po shpresoj që edhe në emër tuajin, të Kuvendit, jemi në vigjilje të përvjetorit të 15-vjetorit të vrasjes së ish-kryetarit të Komunës së Klinës, Ismet Rracit dhe në këtë rast kisha kërkuar që KK, meqë në kohën e vrasjes Ismeti veç ishte Kryetar i Komunës, Kryetari i këtij institucioni, kisha kërkuar që të kemi një deklaratë të përbashkët, ta miratojmë një deklaratë ose emrin ia vëmë si të doni, por kishte për të qenë mirë jo për të na kaluar në heshtje, por të kërkojmë prej organeve tona, ne kemi një polici funksionale, kemi një hetuesi funksionale, kemi prokurori funksionale, po ashtu edhe gjyqësor. Unë po kërkoj të gjitha këtyre organeve dhe pastaj le të miratohet kjo deklaratë, që të paktën prej 2008 janë institucione që udhëhiqen vetë, të pavarura, pa ndikime të asnjë lloji, dhe prej Shpalljes së Pavarësisë kemi institucionet tona. Jemi në vitin 2016, 15 vite pas vrasjes, 8 vite pas Shpalljes së Pavarësisë, dhe akoma as familja, as dega e LDK-së, as LDK-ja në përgjithësi, as KK i Klinës që ishte Kryetar i saj, nuk e kemi të paktën një sinjal a janë duke vazhduar ato hetime, a merret dikush me këtë rast, për të mos thënë më keq, a mos i kanë stopuar krejt ose a i kanë fshehur krejt. Unë kisha kërkuar që të jenë kërkesat tona të përbashkëta karshi këtyre organeve tona dhe prej kësaj deklarate të mos jetë thjesht një miratim i një deklarate, por në bazë të kësaj deklarate, në bazë të kësaj kërkesë tonë si kuvend, le të na vinë përgjigjet. Ne nuk po kërkojmë detajet nëse veç është duke vazhduar hetimi, por të paktën të na thuhet që po vazhdojnë hetimet, jemi në rrugë të mirë, kemi sinjale, janë punë të organeve pastaj. Por neve le të na dhënë informacionin e përgjithshëm dhe të kemi një satisfaksion edhe si familje, edhe si parti, edhe si Kuvend”, ka konstatuar anëtarë Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se secili shef i GP do ta letë fjalën, por desha të them se është një akt i rëndë dhe tragjik që i ka ndodhur Komunës së Klinës, është realisht një moment që përkon me 15-vjetorin e vrasjes makabre të ish-Kryetarit të Komunës. “Ne ditën e vrasjes, gjegjësisht Kuvendi në bashkëpunim me GP i ka bërë homazhet, edhe unë mendoj që thjesht këtij Kuvendi i takon që partitë politike të bëjnë deklaratat, të bëjnë apele drejt organeve tona të drejtësisë për zbardhjen e rastit të vrasjes së ish-Kryetarit të Komunës. Unë mendoj që partitë tona politike kanë stadin e pjekurisë edhe më herët, edhe sot, që të jenë të përgjegjshme konform situatave që ka kaluar ky vend yni. Fadili me të drejtë e paraqiti një qëndrim në këtë rast edhe të LDK-së, por edhe si këshilltar, edhe si qytetar, bashkëkohanik dhe si njeri që ka ecur në këto procese dhe mendoj se nuk ka asgjë të keqe që të harmonizohet një deklaratë e përbashkët të të gjitha partive politike në këtë Kuvend, pastaj si Kuvend të deklarohemi rreth asaj deklarate. Ky është qëndrimi im personal, kurse për qëndrimet politike i ftoj shefat e GP të deklarohen”, theksoi kryesuesi Ibishi.

Halil Desku, tha se në emër të Grupit të asamblistëve të PDK-së e mbështes kërkesën e anëtarit Gashi për të hartuar një deklaratë dhe për ta miratuar në Kuvend.

Tunë Dedaj, tha se në emër të GP të AAK-së, e përshëndesim këtë iniciativë të Fadilit, sepse ai moment i rëndë i ish-kryetarit të Komunës Ismet Rraci, ka qenë ndër momentet më të vështira që ka përjetuar kombi ynë, edhe në e mbështesim dhe e përkrahim që ky rast të zbardhet sa më shpejt.

Ndue Shabanaj, tha se e përkrah këtë iniciativë që të aprovohet një deklaratë e tillë nga AK e Klinës. “Ndoshta ne jemi më të thirrur se sa të gjithë tjerët si AK pavarësisht subjekteve politike që funksionojnë dhe se a i ka takuar LDK-së Ismet Rraci. Bashkëpunëtorë me të kemi qenë, pavarësisht çfarë subjekti politik jemi sot, edhe është një shqetësim jo vetëm i Kuvendit, jo vetëm i subjekteve politike por i gjithë qytetarëve pavarësisht përcaktimeve të tyre politike. Jam në favor të kësaj, që si AK ta kemi një deklaratë dhe përmes saj të sensibilizojmë aq sa kemi mundësi ne dhe ne ta shprehim shqetësimin tonë përmes asaj deklarate. Natyrisht, se nuk është ky rast i vetëm, por dëshira jonë është që të ndikojmë në të gjitha vrasjet që janë vrasje të pasluftës, e që janë të pa zbardhura. Ishte dashur që edhe ky rast të merret si shembull sepse qytetarët kanë pakënaqësinë, a kanë forma të ndryshme të mundësive për t’u deklaruar kjo pakënaqësi dhe port ‘u kanalizuar, kjo është e kufizuar mund të them, por ne si AK e kemi për obligim dhe mendoj që është moment i qëlluar”, ka shtuar prof. Shabanaj.

Skënder Merturi, tha se një ndër rastet më të rënda prej pasluftës deri me sot, besoj për të gjithë, ka qenë dhe shpresojmë që të mos përsëriten më raste të tilla, jo në Klinë, por në asnjë komunë tjetër, ka qenë vrasja e ish-Kryetarit të Komunës, profesorit, arsimtarit tonë Ismet Rracit. “Besoj që të gjithëve na ka prekur dhe të gjithë e ndiejmë mungesën, edhe pse unë mundem më i riu prej atyre që kam njohur, por sadopak edhe personalisht e kam njohur si arsimtar i kësaj Komune të Klinës edhe besoj shumë nxënësve ju ka dhënë mësim. Unë i bashkëngjitëm, përkatësisht pajtohem me atë deklaratë dhe dakordimin me atë deklaratë. Besoj dhe po dua të shpresoj se është një formë ose një lloj kërkimi, ose presioni për thirrje për organet e drejtësisë që ta kryejnë punën e tyre që është bërë një kohë e gjatë dhe nuk ka të paktën ne si qytetarë të Klinës, nuk dimë ndonjë hap konkret që është bërë prej këtyre institucioneve tonë, në thonjëza, të pavarura për të zbardhur rastin e vrasjes së ish-Kryetarit të Komunës. “tu bëjmë thirrje organeve të drejtësisë ta kryejnë punën e tyre, edhe pse dihet, për mua të paktën është vrasje edhe me qëllime edhe motive politike, besoj, por të bëjmë thirrje që organet të thonë fjalën e vet dhe organet ta kryejnë punën e vet ashtu siç duhet, edhe ashtu siç e kanë rolin, edhe ashtu siç e kanë detyrën”, theksoi anëtari Merturi.

Avni Gashi, tha se sa i parkete deklaratës së LDK-së normalisht që e përkrahim. “Është për keqardhje që pas kaq viteve ende nuk ka asgjë në zbardhjen e një prej vrasjeve më makabre në Komunën e Klinës, Kryetarin e Komunës të parë, një aktivisti të shquar të periudhës më të vështirë tonë, kur çdo herë është gjendur në ballë të të gjitha organizimeve kombëtare, i cili edhe pas luftës arriti për t’i bërë bashkë të gjitha forcat politike dhe për të vazhduar përpara. Është shumë keq që nuk është bërë asgjë në atë drejtim, kjo është më e pakta që mund ta bëjmë si subjekte politike. E përkrahim plotësisht deklaratën që kanë propozuar LDK-ja”, nënvizoi anëtari Gashi.

Bozhidar Sharkoviq, tha se normalisht që unë i bashkëngjitëm kësaj iniciative që të zbardhet kjo vrasje. “Personalisht e kam njohur profesorin Rraci, edhe nuk ka qenë vetëm një humbje për partinë LDK të cilën e ka udhëhequr zoti Rugova, por ka qenë humbje për gjithë politikën, e cila është dashur të udhëhiqet në Kosovë. Edhe unë i bashkëngjitëm kësaj iniciative”, theksoi anëtari Sharkoviq.

Haxhi Ibishi, tha se ftoj gjithë kryetarët e GP që gjatë seancës që në pikën që kemi kah fundi i seancës të na bien me shkrim tekstin e deklaratës të harmonizuar dhe mendoj që Kuvendi do të jetë organi i fundit që do ta votojë në mënyrë plebishitare, arbitrare deklarimin publik të të gjitha partive politike.

Enver Berisha, nënkryetar i Komunës, theksoi se sot kam dalë këtu ta jap një deklaram personal: “Duke e parë edhe shembullin e Kryetarit të Komunës, me të cilin qysh më herët kemi pasur bisedë dhe dakordim që atë vendim ta bëjmë bashkërisht. Është fjala për një banesë, që unë e kam në shfrytëzim që një periudhë, për të cilën deklaroj nga sot heq dorë nga shfrytëzimi i saj. Nuk e kam bërë në kohën kur e ka bërë Kryetari i Komunës vetëm për një arsye dhe ajo ka qenë për shkak të hetimit që është zhvilluar para një viti e sa në këtë drejtim, se përndryshe në kohën kur kam krijuar kushtet e reja të banimit në Klinë unë në atë moment do ta kisha bërë dorëzimin e saj. Por duke u nisur nga individë të papërgjegjshëm që përfaqësojnë partitë politike, që jo vetëm këtu, po kudo në Kosovë, të cilët po mundohen që të krijojnë ngjarje dhe rrethana që janë jashtëzakonisht jo serioze dhe të dëmshme, edhe janë jashtëzakonisht jo serioze dhe të dëmshme kur kam parasysh kolegët e mi që janë në këtë sallë dhe të tjerët që nuk janë këtu, e që janë shfrytëzues të atyre banesave që i kanë marrë me vendim dhe me një komision që ka punuar jashtëzakonisht në mënyrë serioze, dhe një pjesë e juaj që jeni këtu edhe si asamblistë e asaj periudhe, ka pasur shumë dilema, shume teza, shumë debate, të llojllojshme komisioni nuk ka kryer punën e vet, se ka pasur ndërhyrje politike, se ka pasur marrëveshje politike, dhe unë për gjitha këto ju them juve me sinjeritetin dhe me vetëdijen e plotë se as nuk pa pasur ndërhyrje në komision, i cili ka kryer punën as nuk ka pasur marrëveshje politike, as asnjë organ, as individ që ka të bëjë me këto tema nuk mund të dalë dhe të argumentojë se Enver Berisha është marrë vesh në cilindo variant me cilindo anëtar të komisionit ose anëtar të AK të asaj periudhe për marrjen në shfrytëzim të asaj banese. Dhe nga sot, u në lus edhe Zyrën Ligjore që të nxjerrë vendimin dhe ta bëjë dorëzimin e saj. Por, realisht kam për obligim për ta thënë edhe para jush, nganjëherë mandati dhe përgjegjësia e asamblistit po shfrytëzohet për elemente jashtëzakonisht të dobëta, të ulëta, dhe unë kisha kërkuar që të ndërpriten këto praktika, sepse në fund të fundit ne jemi qytetarë të këtij vendi, jemi njerëz që takohemi përditë, jemi familje që njihemi mes vete, e dimë kontributin e gjithsecilit, qoftë në periudha të më hershme, qoftë më të vonshme dhe nuk është mirë për të pretenduar dhe për të punuar dikush me diktime çfarë vinë nga qarqe dhe iniciativa të llojllojshme dhe të bëjnë përpjekje për të hedhur këso zhvillime dhe këso rrethana në institucionin tonë. Le të mendojë cilido që është marrë me këto tema dhe që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite se lëndojnë familje, shqetësojnë familje, që shfrytëzojnë ato banesa. Ato nuk janë pronë e asnjërit, janë prona komunale, janë të dhëna në shfrytëzim ju paguhet qiraja edhe për pak kohë ju kalon edhe ai mandat. Dhe prapë do të jeni ju ajo Asamble ose e radhës që do të vendosni a duhet për t’ju vazhduar atë shfrytëzim të atyre banesave apo jo. Po me duhet të prezantoj edhe një çështje të një nivel të keq: aq të nivelit të keq ka kjo Asamble, përfaqësues të partive politike, sa ju pengon dhe merren edhe me darkën që unë e ngrënë me një mik nga Amerika. Dhe për çudi dhe nivelin e tij ai thotë “këqyri këta që hanë darka me paranë e popullit!” Ai mirë e di se nuk kemi nevojë për ato darka, shqyr i kemi mundësitë për t’i ngrënë ato darka, merreni me mend çfarë niveli të asamblistëve kemi. Merren me darkat e kolegëve të tyre ose njerëzve që përfaqësojnë institucionet, që nuk po bëkan që as në darka të dalin me mikun për të ngrënë në mbrëmje. Kjo është jashtëzakonisht e ulët. Dhe ju kisha lutur ndaleni këto praktika se vërtet jeni duke çoroditur këtë assemble, përfaqësimin e partive që keni edhe mënyrën qysh realisht duhet për të përfaqësuar një nivel i një përfaqësuesi të popullit, i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm dhe për temat për të cilat është deklaruar në popull se me çka duhet të punohet dhe të merret. Kuptojeni drejt rolin e asamblistit, jo kështu, në këtë formë të çoroditur”, ka konstatuar nënkryetari Berisha.

Haxhi Ibishi, theksoi se rreth rendit të ditës e kemi një propozim të dakorduar prej të gjitha partive politike, që të hyjë si pikë e shtatë e rendit të ditës, Aprovimi i Deklaratës së Kuvendit të Komunës rreth vrasjes ish-Kryetarit të Komunës, Ismet Rraci.

Vuri në miratim rendin e ditës me pikën plotësuese.

Me vota unanime (25) u miratua ky

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-mars 2016 (ref.Drejtoria e FEZH),
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës (ref. DKA),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim- vendimeve për ndërrim të destinimit të tokës prej asaj bujqësore në tokë ndërtimore dy ngastra:
 - a. Në ZK-Këpuz, ngastra me nr.P-7 011046-00279-1,
 - b. NE ZK-Deiq, ngastra me nr.P-7111065-00100-2,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë së Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së për mbulim të shpenzimeve për periudhën janar- prill 016,
7. Aprovimi i Deklaratës së Kuvendit të Komunës rreth vrasjes ish- Kryetarit të Komunës, Ismet Rraci.
8. Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi Ibishi sqaroi se ka arsyetim për dy mungesa, për anëtarin Pjetër Coli dhe anëtare Violeta Zefi.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me 25 vota pro u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-mars 2016 (ref. Drejtoria e FEZH).

Kryesuesi Ibishi foli rreth pikës në rend të ditës. Fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë FEZH, raportoi rreth Raportit financiar për periudhën janar-mars 2016. “Ashtu siç është e praktikuar që në çdo tre muaj të përgatisim raportin financiar të shpenzimeve dhe ta raportojmë para jush këtu, besoj që jemi edhe me kohën. “Më 18 prill kemi mbajtur KPF-në dhe aty kemi biseduar rreth këtij raporti financiar, ndoshta pak më me pika të shkurtra që sa sot këtu para jush do ta paraqesim si drejtori e Financave këtë raport të shpenzimeve për periudhën janar – mars 2016. Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – mars 2016 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe do të analizojmë disa trendet të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetorë për këtë periudhë, pra në krahasim në vitin paraprak me tremujorin e këtij viti në vitin 2015. Në tabelën nr. 2, kemi buxhetin sipas sistemit të menaxhimit të financave. Keni grandin qeveritar, të hyrat vetanake, të cilat janë për këtë vit bukur shumë të planifikuara dhe urojmë që këto të realizohen. Të hyrat e bartura, vlerën, participimin e qytetarëve, një fondacion Save the Children, ku buxheti total është në vlerë prej 8,557,937.88 euro. Përqindjet shihet aty për sa, buxheti total përfshihet prej grantit qeveritar prej të hyrave të bartura nuk kam nevojë t’ju paraqes numra se i keni përpara, dhe buxheti në anën e djathtë e vitit 2015. Pasi që shihet nga kjo tabelë buxheti sipas sistemit të menaxhimit për janar-mars është më i vogël për rreth 1.78% se buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2015. Në tabel. nr. 4, buxheti sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar për në këtë periudhë tremujore. Nga granti qeveritar janë shpenzuar janë shpenzuar 1,869,029.23 € (25.58 % në raport me buxhetin nga granti), nga të hyrat vetanake 11,597.10 € (1.13 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2016), nga të hyrat e bartura 8,419.72 € (4.08% në raport me buxhetin nga

të hyrat e bartura), dhe nga donacioni i Save the Children janë shpenzuar 2,168.73 € (100% në raport me buxhetin nga donacioni). Çka do të thotë buxheti është 22.10 për qind i shpenzuar në këtë periudhë tremujore. Në total krahasuar këtë periudhë tremujore kemi buxhet të shpenzuar më pak për 8.07%. Në tab. nr. 5 keni shpenzimet e buxhetit në periudhën janar – mars 2016 sipas kategorive ekonomike. Për paga dhe mëditje 1 414 197 euro të shpenzuara, për mallra dhe shërbime, 155,830.91, shërbimet komunale 44,965.05, subvencione dhe transere 350.00 euro, kapitalet 275,870.98, çka do të thotë që në këtë periudhë janë harxhuar 1,891,214.78, krahasuar me periudhën e njëjtë të tremujorit të vitit të kaluar, paga dhe mëditje 6.57 për qind më tepër, mallra dhe shërbime kemi më pak 17.83 për qind, shërbime komunale 9.25 për qind, subvencione dhe transfere kemi 98.56 për qind më pak të shpenzuara dhe kapitale kemi minus 40.07 për qind më pak të shpenzuara në këtë periudhë tremujore. Të hyrat të realizuar në periudhën janar – mars 2016 dhe krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar: tatimi në pronë kemi minus 15 për qind çka do të thotë diku minus 9 000 euro kemi më pak të hyra në këtë periudhë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, taksa për rrugë kemi rritje, në urbanizëm kemi rritje për 6718 euro, certifikatat e lindjes kemi minus 843 euro. Në fund kam një informacion për t'ju dhënë se atje në tabelar e keni gjithsej të hyrat, ju del në anën e djathtë minus 14 185 euro. Para tri ditëve na kanë ardhur gjobat prej gjykatës ku kemi një shumë prej 24 935 euro dhe këto janë regjistruar në periudhën janar – mars, por kanë ardhur me vonesë, çka do të thotë se të hyrat për këtë periudhë janë 10 746 euro më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar, domethënë me gjobat që kanë ardhur nga gjykata. Raporti i shpenzimeve për periudhën janar-mars 2016, i keni të gjitha shumë mirë të detajuara, besoj se keni për të bërë pyetje për secilën kategori që juve ju intereson, edhe unë besoj shumë që Shërbimi i Kuvendit ju ka ofruar raportin për secilën drejtori në formatin e zmadhuar, po që se nuk i keni mund t'ju ofrojmë ngase i kemi të gatshëm”, ka raportuar drejtori Rrusta.

Haxhi Ibishi, falënderoi drejtorin Rrusta për prezantimin dinjitoz të raportit. Hapi debatin rreth raportit.

Tunë Dedaj, tha se unë në emër të GP të AAK-së desha t'i jap disa vërejtje rreth shpenzimeve të prezantuara në raportin për periudhën janar – mars 2016, ku sipas nesh janë të mëdha.” Shpenzimet për telefoni Vala, parë është e madhe 6 916 euro, ku sipas mendimit tonë kjo shumë asnjëherë nuk po zbritet, mirëpo vetëm po shkon në ngritje. Edhe karburantet për vetura, 11 662 euro, për një periudhë kaq të shkurtër, që mendoj është shumë tepër e lartë, por nuk e di a ju bëni ndonjë herë kontrollim kilometrazhit që i kanë veturat se ato nuk kanë mundësi të shpenzojnë jashtë normave. Mirëmbajtja e shkollave 15 933 euro, nuk di çfarë mirëmbajtje, ku janë shpenzuar këtë para, ku ne gjendjen në shkollat tona e dimë qysh janë. Kemi shkolla që nuk kanë nyja sanitare. Ndërtimi i rrugëve lokal po thotë 8 6000 euro, nuk po e di këtu për çfarë ndërtimi bëhet fjala, asfaltim apo çka, po që se është asfaltim arsyetohet, po që se është për ndërtim të rrugëve lokale që janë të paasfaltuara nuk e di, se të gjitha rrugët të paasfaltuara në komunën e Klinës janë në gjendje shumë të keqe. Më ra në sy, pagesa e vendimeve gjyqësore, 88 798 euro. Mendimi ynë është se është punuar keq, edhe kur punohet keq vendimet e gjyqit vijnë për t'i paguar me këtë shumë kaq marramendëse, për gabimet që i ka bërë ekzekutivi ynë. Prandaj ne si grup i AAK-së nuk e përkrahim këtë raport”, ka theksuar anëtari Dedaj.

Arben Limani, tha se për shpenzimet buxhetore për tremujorin janar – mars 2016, kam nxjerrë disa prej shqetësimeve që ne i paraqesim si grup sot para Asamblesë. “Tek tab. 2, buxheti për periudhën janar – mars 2016 është realizuar 22.10 për qind, pak më pak se ¼ e buxhetit vjetor. Por nëse e shikojmë sipas burimeve të të hyrave nga të hyrat vetanake është shpenzuar 1.13 për qind e të hyrave të planifikuara që është shumë më pak. Përveç kësaj buxheti i shpenzuar janar-mars 2016 është 8.07 për qind, më pak se buxheti i shpenzuar janar – mars 2015. Këto dy fakte tregojnë për një menaxhim jot të mirë të buxhetit. Tab. 3 përkundër faktit që shpenzimi i buxhetit ka një progres të drejtë në krahasim me planin pasi është shpenzuar afërsisht ¼ e buxhetit dhe shpenzimet kapitale kanë ngecje, pasi janë realizuar vetëm 14/59 për qind. Tek tab. e të hyrave vetanake, të hyrat vetanake të planifikuara me buxhet, do të thotë është bërë një planifikim ambicioz dhe krahasuar me vitet e tjera, edhe pse me mundësi reale për t'u realizuar. Por nga ana tjetër trendi i inkasimit të të hyrave vetanake gjatë kësaj periudhe tregon për një dështim sa i përket realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me ato të planifikuara, por edhe në krahasim me të hyrat e realizuara në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Në krahasim

me vitin e kaluar të hyrat e këtij tremujori janë 9.28 për qind më pak se në vitin 2015 për të njëjtën periudhë që po flasim. Ndërsa shumë i keq është raporti i të hyrave të realizuara në periudhën janar mars 2016 në krahasim me të hyrat vetanake të planifikuara për këtë vit, pasi edhe pse është kaluar një tremujor ato janë realizuar vetëm 1 386 46.65, ose 13.49 për qind të të hyrave të planifikuara për vitin 2016. Tabela e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve: Pasi ky është raport tremujor i këtij viti dhe ndoshta është herët për të bërë ndonjë konstatim për tejkalim të shpenzimeve normale sipas kodeve ekonomike megjithatë druajmë që trendi i shpenzimeve po përsëritet njëjtë dhe raport pas raporti po shkon e njëjta sa i takon këtyre shpenzimeve dhe kurrësi të ndalet trendi i shpenzimeve në vlera jo normale. Po i potencoj disa kategori të caktuara që vazhdimisht i cekim këtu për shpenzime të tepuara, siç janë shpenzimet e udhëtimit 5,916.02 euro, shpenzimet e telefonit “Vala 900”, 6 916.02 euro, shërbime kontraktuese 11 748.43 euro dhe karburante për vetura 11 662. Megjithatë po e theksojmë edhe një herë se ky raport është i një fillim viti dhe nuk paraqet një pasqyrë reale të shpenzimeve pasi që mund të supozojmë në besueshmërinë e madhe se shpenzimet në këtë tremujor në të gjitha kategoritë janë shumë më të mëdha, se këto që janë prezantuar në këtë raport, pasi që raporti është i përgatitur mbi bazën e parasë së gatshme, që domethënë raporti përmban vetëm shpenzimet e paguara e jo edhe ato që faktikisht janë shpenzuar, por që ende nuk janë paguar, e që do të reflektohet në raportet të ardhshme tremujore kur sigurisht këto shpenzime do të vinë duke u rritur vazhdimisht dhe po vërehet që nuk ka pasur përpjekje dhe angazhime të duhura për zvogëlimin e tyre. Gjithashtu shqetësim paraqesin edhe pagesat e pajustificueshme të vendimeve gjyqësore”, ka konstatuar anëtari Limani.

Petrit Palushi, tha se unë kam një pyetje: “Kë e bëni përgjegjës për pagesën në shumë prej 88 000 euro? Edhe tek, pajisje të tjera, për çfarë pajisje është fjala për shumën 8 360 euro, kurse për naftë, qymyr dhe dru, a është ky shpenzim vetëm për tremujorin e fundit apo edhe para këtij viti, d.m.th. 2015”, pohoi anëtari Palushi.

Avni Gashi, tha se drejtori po kryen punën e vet, po i prezanton tabelat, po realisht ajo që nuk po më pëlqen diçka që ne mund ta kuptojmë është krahasimi i 2016 me 2015, në vend të që të krahasohet me planifikimin e bërë prej ekzekutivit në krahasojmë vitin e kaluar, krahasojmë vetëm numrat. Kisha pasur dëshirë për t’i parë këto të krahasuarat çka ka planifikuar ekzekutivi për të harxhuar në këtë vit edhe çka kanë harxhuar. Shembull, këtu po nisemi prej një planifikimi ku qytetarët i kanë sytë kah ato shpenzime, domethënë te investimet kapitale, ne kemi kundërshtuar investimet kapitale që planifikimi ka qenë jashtëzakonisht i keq, ajo po shihet, tash jemi veç afër muajit maj janë shpenzuar vetëm 13 për qind të investimeve kapitale prej tyre mbi 30 për qind vendim gjyqësor. Realisht investimet kapitale, përkatësisht mjetet e ndara për investime kapitale as që janë prekur për shkak të gabimeve që janë bërë nga ekzekutivi. Për më shumë në detaje për të hyrë kolegët veç i potencuan të gjitha pikat tjera”, nënvizoi anëtari Gashi.

Skënder Merturi, tha se fillimisht desha që drejtori të paktën të ketë mundësi të më shpjegojë se një gjë nuk e kam të qartë, e para është, paga neto përmes listave, edhe e dyta, rroga dhe paga, dallimi në mes të kësaj, ndoshta mund ta kem gabim, por unë nuk jam duke mund për të ta gjejë, e para. “Tjetra, është po që se shkojmë kështu, të Zyra e Kryetarit, po me duket pak si shumë, edhe pyetja konkrete pasi që është Kryetari këtu, sa vetë paguhet të Zyra e Kryetarit, që është te rrogat dhe pagat 18 643.24 euro. Po ashtu te ZK për tre muaj telefonia Vala është 2 048 euro. Po ashtu te ZK karburante është për veturë 1 225.81. Kjo tregon se është një shumë e madhe. Tjetra, shërbime kontraktuese të tjera, unë e kam vërejtur shuma është 5 931.21 euro, te shëndetësia, kisha pasur dëshirë drejtori të na sqarojë çfarë është kjo më në detaje që gjendja në shëndetësi nuk është e mirë në nivel të Kosovës e lëre më në Klinë, që goxha e keqe është. Dru, po ashtu te shëndetësia është 8 000 euro, për tre muaj kjo shumë është e madhe, kur dihet që dimri nuk ka qenë edhe aq i ftohtë. Karburante për vetura po ashtu te DSH është 5 116.85 edhe këtu drejtor e di që kaq shumë karburant shkon. Kjo dëshmon që shëndetësia në Klinë nuk është në gjendje të mirë për shkak se për çdo rast njerëzit i çojnë në Pejë dhe ata të Pejës bëjnë humor me ne se po na sillni raste shumë të lehta që kishin pasur mundësi që në Klinë të kryhen këto raste, sikur të kishin qenë çështjet të koordinuara dhe të menaxhuara punët më mirë”, theksoi anëtari Merturi.

Lorenc Marleku, tha se u adresuan shumë vërejtje në drejtim të ekzekutivit me të cilat edhe pajtohem. “Unë isha ndalur te ndërtimi i rrugëve lokale, kisha pasur dëshirë të në shpjegohet, ne nuk po ndëtojmë autostrada në Klinë, por rrugë lokale, ku janë ato dhe ku janë shpenzuar këto 86 665 euro, kur e dimë se rrugët lokale në Klinë janë në gjendje shumë të keqe dhe kemi rrugë lokale në Klinë që s’ka shtresë asfalti. Të na sqarohet më qartë se ku janë ndërtuar këto rrugë, përkatësisht ka shkuar kjo shumë e mjeteve prej 86 665 euro për rrugë lokale në këtë periudhë”, shtoi anëtari Marleku.

Rasim Millaku, theksoi se leximi i këtij raporti që e prezantoi Drejtoria për Ekonomi, vërej, kisha dashur për t’i quajtur disa gabime teknike, duke filluar nga kodi ekonomik 13 140 kemi shpenzim 125 euro, por pa përshkrim, kisha thënë që është gabim teknik, kodi 14 130 prapë kemi shpenzim 3148 euro pa emërtim të shpenzimeve, fq. 9. Pastaj te listat e tha drejtori që ne prezantojmë një raport krahasues, fakt që kemi krahasim tek të hyrave, por jo edhe të shpenzimeve. Këtu në raportin që unë e kam nuk kemi një krahasim të periudhave të ngjashme të vitit të kaluar të shpenzimet. Një vërejtje tjetër që unë vazhdimisht e kam bërë thuhet “shpenzim i telefonisë Vala”, unë e di që asnjë cent ekzekutivi nuk e ka bërë tek telefonja “Vala”, prandaj është mirë për t’i përmirësuar kodet, sepse mund të ndodh që atëherë vala të kërkojë ndonjë kompensim, sepse përdorimi i emrit është shkelje. Nuk ka ekzekutivi në “Vala” asnjë cent. Dhe nuk kemi krahasim, pa të keq, drejtori nuk duhet ta marr personale sepse këto shpenzime nuk i ka bërë vetë, mirëpo krahasimi disiplinon. Jemi dëshmitarë vetë se disa drejtori janë disiplinuar falë edhe kritikave që u janë bërë, që ligjërisht ne jemi këtu për t’ju bërë. Vërejtja në të hyra pavarësisht disa regreseve ose uljeve një ngritje të madhe në Drejtorinë e Urbanizmit mbi 100 për qind dhe në shumicën e rasteve tek të hyrat ky tremujor nuk është më i mirë se viti i kaluar”, ka konstatuar anëtari Millaku.

Ramiz Rrusta tha se do të bëj përpjekje të jem i shkurtër dhe po më vjen mirë që kësaj radhe drekat nuk u potencuan, pasi që keni vërejtur që nuk kemi shpenzuar, prandaj nuk kemi pasur as çfarë të thoni, që janë disa drejtori që nuk kanë shpenzuar asnjë cent. “Ju them sinqerisht që shpenzimet në këtë periudhë tremujore janë shumë më pak se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar, ndërsa të hyrat me raportin që na ka ardhur prej gjobave nga gjykatat thashë kemi një rritje prej 10 746 euro, që ne i kemi regjistruar këtu në raport e thashë diku para tri ditëve i kemi regjistruar, që janë në raport të tremujorit që ju nuk i keni, që unë i prezantova. Aty është gabim Rasimi mirë e tha, gabim teknik se nuk kemi marrëveshje me Valën, tash e kemi një marrëveshje me IPKO-n, edhe nuk është shumë e madhe duke marrë parasysh numrin e telefonave, ku në mbledhjen e BD që kemi pasur në fillim të vitit bashkë me Kryetarin kemi marrë vendim se të gjithë ata drejtorë që në vitin e kaluar kanë tejkaluar shpenzimet në bazë të marrëveshjes që kemi me IPKO secilit është duke ju ndalur për një periudhë 6-mujore në pagë shuma e tejkaluar e telefonit që ka shpenzuar për vitin e kaluar. Mirëmbajtja e shkollave, dihet diku 30 shkolla janë, unë vetëm i paraqes shpenzimet, më kompetent është drejtori i DKA-së të jap sqarime. Te ndërtimi i rrugëve lokale është drejtori i urbanizmit, por shikoni, keni këtë periudhë kështu, sepse këto janë pagesa që janë bërë edhe për punët që janë kryer edhe për vitin e kaluar. Sepse dihet fare mirë se ne inkasojmë të hyra deri më 31 dhjetor për vitin e kaluar, ndërsa pagesat fillojnë diku prej periudhës shkurt-mars edhe për atë dalin që shpenzimet janë bërë. Çdo faturë që vjen ajo llogaritet si punë e kryer. Te vendimet gjyqësore është një vendim gjyqësor, që është marrë përmbartuesi me këtë lëndë, këtu është Ali Shala, që njeh më mirë këtë lëndë, ne i kemi bërë ankesat tona si drejtori për buxhet dhe financa, e di që ish-drejtori më herët kishte formuar një komision për këtë çështje që nuk ka funksionuar, kur kam shkuar unë kemi ndërprerë këtë kontratë me këtë kompani dhe lënda është deri në Gjykatën supreme. Arben llogaria po më del që buxheti do të del diku mbi 90 për qind i shpenzuar në mënyrë të planifikuar. Të hyrat e planifikuar, në ekonomi çdo gjë që planifikohet nuk realizohet. Ne Ministria na ka ngarkuar për vitin 2016 me 128 000 euro që duhet realizuar të hyra vetanake. Derisa vitin e kaluar kemi pasur 85 7000 euro, sivjet kemi 128 000 euro, domethënë ata na kanë ngarkuar në krahasim me vitin e kaluar për 19.25 për qind, çka do të thotë që ne ato çka planifikohet rrallëherë që realizohet, nuk është faji tek ne dhe muajt janar, shkurt mars llogariten si muajt të vdekur, kemi njerëz që paguajnë më pak tatimin, plus ka krijuar në konfuzion edhe falja e kamatave dhe njerëzit janë vetëdijesuar dhe po vinë për t’u sqaruar, nuk është keq. Udhëtimet brenda vendit, ju kam sqaruar edhe më herët, janë të nxënësve që krijohen prej DKA-së, janë nxënës me nevoja të veçanta, ne kemi për obligim për të paguar udhëtimet e tyre në Pejë,

Prizren dhe udhëtime të tjera. Nuk janë udhëtime që i bën as Kryetari as asnjë prej drejtorëve të ekzekutivit. Nuk pajtohet me atë që u tha këtu se nuk ka përpjekje të zvogëlimeve të shpenzimeve, ka përpjekje ku tregojnë edhe faktet. Planifikimi, thashë ata vetë i caktojnë parametrat, Ministria e Financave është vetëm me për të na i qitur 1 28 000 euro kur dihet Komuna e Klinës çfarë kapaciteti ka. Me siguri janë nisur edhe nga ajo që më 2014 diku 9 16 000 euro janë realizuar. Te kryetari sa punëtorë janë e keni numrin e punëtorëve që janë në kuadër të ZK, janë diku afër 15 punëtorë. Është Zyra Ligjore, Zyra e Auditimit të Brendshëm etj. Pra janë diku 15 punëtorë të cilët me i krahasuar me shpenzimet nuk dalin shumë. Shërbimet kontraktuese janë ato shërbime që kompanitë e pastrimit të objekteve, qoftë të Komunës, të Shtëpisë së Shëndetit, të Shtëpisë së Kulturës të gjitha janë shërbime kontraktuese. Te drutë, dikush e potencoi shpenzimin e tepërt të druve dhe derivateve, këto janë pagesa që vinë pas përfundimit të vitit të kaluar dhe atëherë kur edhe është ligj kur operatori ekonomik i sjell faturat ne nuk guxojmë në një periudhë prej 30 ditë të mos ia kryer obligimet. Domethënë drutë janë harxhuar në nëntor apo dhjetor, ndërsa faturat vijnë diku në shkurt. Te kodet, shpresoj se në raportet e drejtorive janë të gjitha ato kode. Në raport të drejtorëve keni secilin kod dhe sqaron secilin shpenzim”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Haxhi Ibishi, pasi përshëndeti kryetarin Bashota dhe theksoi se në kualifikimin e djeshëm që ka qenë Klina merret prej komunave që pjesëmarrja e Kryetarit në seance të KK-së është më e pranishmja në nivel të Republikës.

Sokol Bashota, tha se unë nuk do të hyj në detaje të raportit që prezantoi drejtori, sepse ky paraqiti materialin dhe mund të jep përgjigje ai në pyetjet e juaja, edhe më detajisht po që se keni nevojë. “Por desha për t’u ndalur tek kualifikimet që nganjëherë po i bëni në mënyrë të nxituar. Dhe të quhet “keqmenaxhim” nga ekzekutivi duhet ofruar edhe argumentet, se besoj nuk ka punë të keqe nga ekzekutivi për shpenzimet kapitale, por pikërisht që ka një menaxhim të mirë janë edhe këto raporte si të tilla, për arsye se nga ky vit ka hyrë në fuqi që asnjë projekt nuk mund të tenderohet pa pasur edhe projektin detal zbatues. Më herët kanë mundur ndoshta edhe me paramasa dhe paralogari, kur është ditur që është krijuar një kulturë e punës për të cilat nuk ka pasur nevojë të shpenzohet mjete materiale për projekte. Tash është marrë një vendim qeveritar prandaj ne kemi për obligim për ta zbatuar. Janë kontraktuesit e kompanive që i përpilojnë projektet për secilin projekt kapital që ka Komuna e Klinës. Kështu që jemi brenda agjendës dhe të jeni të sigurt kemi edhe projekte shtesë që kemi realizuar këtë vit, përkundër faktit që po që ta kemi edhe buxhetin e krejt R. Kosovës do të ishim të sigurt se do ta kishim menaxhuar vetëm për Klinën dhe nuk na kishin dalë, krejt në interes dhe shërbim të qytetarëve. Janë do shpenzime, 80 mijë euro që i vërejtët aty, për rrugë, ju e dini që shumë prej atyre projekteve janë projekte dyvjeçare, apo janë edhe garanci të përqindjeve që Komuna ju ndalë kompanive të cilat kanë realizuar projektet. Këto janë që janë paguar nga tre përqindëshi që Komuna i detyron, përkatësisht i ndalë mjetet çdo firme derisa ka afatin e garancës. Prandaj, këto janë pagesat. Për të tjerat, besoj që shumë shpejt do të fillojë grumbullimi i punëve, ne veç i kemi përgatitur disa projekte detale dhe shumë shpejt do ta shihni edhe punën në terren”, ka konstatuar kryetari Bashota.

Bedri Gashi (drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), theksoi se mendoj që është një trend jashtëzakonisht pozitiv i uljes së shpenzimeve dhe të derivateve në QKMF-në, nëse i shohim raportet paraprake të vitit 2013 dhe 2014, dhe 2015, të paktën prej kohës kur unë jam në menaxhim. “Kësaj radhe ky tremujor është jashtëzakonisht ka ulje të shpenzimeve. Për shembull për muajin shkurt i kemi vetëm 1470 euro shpenzime të derivateve dhe duhet të jetë parasysh që këtu është edhe Qendra Sociale. Drejtori i Financave e tha që muaji nëntor dhe dhjetor janë të bartura, në këtë tremujor të shpenzimeve, prandaj unë mendoj që absolutisht nuk qëndrojnë të dhënat që shpenzimet e tremujorit të derivateve në QKMF janë të mëdha. Nëse vazhdon kështu trendi i derivateve që mesatarja është diku 2000-2200 euro në muaj për dy drejtoritë që i menaxhoj, domethënë që janë nën menaxhimin tim, unë mendoj që është një trend jashtëzakonisht pozitiv dhe duhet të kihet konsideratë”, ka shtuar drejtori Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin për menaxhimin financiar janar- mars 2016.

Me 13 vota për, 11 kundër u miratuar Raporti I menaxhimit financiar për periudhën janar-mars 2016.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës (ref. DKA).

Haxhi Ibishi, tha se ju jeni në dijeni që në seancën e kaluar i kemi bërë të gjitha ato veprimet që duhet për miratimin e një rregulloreje, karshi vendimit paraparak që kemi marrë me propozimin e Kryetarit për ndarjen e bursave, po e di që Komisioni për Arsim pas debatit me publikun, në mungesë të kuorumit nuk është tubuar, me sugjerimin e DKA-së dhe ZL, është parë e udhës që kjo rregullore të shtyhet për miratim edhe një herë për arsye se në debatin me qytetarë kanë dalë propozime konkrete, edhe të harmonizohen me këtë projekt-rregullore që është në versionin paraparak. “Nëse ju pajtoheni këtë rregullore e kishim shtyrë për maj, në mënyrë që edhe një herë ZL bashkë me DKA-në, edhe Komisionin për Arsim, Kulturë dhe Sport të debatojmë dhe të shohim t’i harmonizojmë propozimet që kanë dalë nga debate me publikun”, tha Kryesuesi.

Vlora Tafili, tha se në emër të grupit të AAK-së e kisha shprehur një propozim-ndryshim te neni 15, tek procedura e pagesave, pse të mos bëhet pagesa muaj për muaj port ë jetë procedura dy herë në vit, sepse studentët i kishin planifikuar më mirë shpenzimet mujore edhe ne si studentë kemi shpenzime universitare për çdo muaj dhe jo vetëm dy herë në vit.

Haxhi Ibishi, theksoi se pikërisht për këto që i ngritët anëtarja Tafili, këto shqetësime, është mirë që kjo rregullore edhe një herë të debatohet prej strukturave profesionale tona. “Kur e marrim edhe këtë propozim tëndin, edhe propozimet tjera, prandaj mendoj që ende nuk është pjekë për t’u vënë në miratim”, shtoi Kryesuesi.

Vuri në miratim propozimin për shtyrje për seancën e radhë për miratim të Projekt-rregullores për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës.

Me vota unanime (25 vota) u miratua propozimi.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve për ndërrim të destinimit të tokës prej asaj bujqësore në tokë ndërtimore dy ngastra:

- a. Në ZK-Këpuz, ngastra me nr.P-7 011046-00279-1,
- b. NE ZK-Deiq, ngastra me nr.P-7111065-00100-2.

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në debat. Fjalën dhe deklarinimin e barti te kryetarët e grupeve të anëtarëve.

Kryetarët e grupeve të anëtarëve: Halil Desku (PDK), Arben Limani (LDK), Tunë Dedaj (AAK), Skënder Merturi (VV), Bozhidar Sharkoviq (Lista serbe) Ndue Shabanaj (IPK), mbështeten propozim-vendimin për ndërrim të destinimit të tokës prej asaj bujqësore në tokë ndërtimore për dy ngastrat: a. Në ZK-Këpuz, ngastra me nr.P-7 011046-00279-1,
b. Në ZK-Deiq, ngastra me nr.P-7111065-00100-2.

Fadil Gashi, kërkoi që të respektohet rregullorja.

Haxhi Ibishi, tha se e bëra për hir të një dakordancës të përgjithshme do t’i respektoj në plotni grupet kuvendare. “Do të kemi edhe një riorgaizim të grupeve kuvendare bashkë edhe me ju”, theksoi Kryesuesi.

Kryesuesi Ibishi vuri në miratim propozim-vendimin e parë për ndërrim të destinimit të tokës prej asaj bujqësore në tokë ndërtimore të ngastrës në ZK-Këpuz, ngastra me nr.P-7 011046-00279-1.

Me vota unanime (24) u miratua propozim-vendimi.

Kryesuesi vuri në miratim propozim-vendimin e dytë për ndërrim të destinimit të tokës prej asaj bujqësore në tokë ndërtimore të ngastrës në ZK-Deiq, ngastra me nr. P-7111065-00100-2.

Me vota unanime (24) u miratua propozim-vendimi.

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi që për hir të kohës kryetarët e Grupeve Kuvendare të takohen në Zyrën e Kryesuesit dhe të hartojnë deklaratën që do ta miratojë Kuvendi i Komunës, si pikë e shtat e rendit të ditës.

Ndue Shabanaj, tha se janë dy çështje këtu: nëse deklarata në një formë është e hartuar dhe në mund ta shqyrtojmë atë deklaratë ose ta plotësojmë, është diçka tjetër. “Nëse ajo kërkohet të shkruhet sot, mendoj që kërkon kohë ajo dhe nuk di a do të kemi mundësi që brenda kësaj seance të përgatitet dhe të debatojmë, aktualiteti është, edhe nëse nuk e aprovojmë në këtë seancë ajo vjen nga aktualiteti, jo se bien, por e ka kohën për t’u aprovuar”, shtoi prof. Shabanaj.

Sokol Bashota, tha se po që se sot nuk miratohet deklarata e humb aktualitetin. “Ne realisht po bëjmë një presion edhe pse organet e drejtësisë ato është dashur për ta ditur punën e vet pa këtë presionin tonë pa bërë ne thirrje si qytetarë të Komunës së Klinës thjeshtë edhe pas kaq viteve jemi të shqetësuar për këtë ngjarje që ka tronditur jo veç Klinën dhe qytetarët e saj por gjithë opinionin kosovar, shumë më shumë ata njerëz që kanë pasur fatin për të qenë përkrah tij. Të caktohet një grup, njohës të shkrimit dhe hartimit të teksteve dhe në t’ia japim vizën si Kuvend atij grupi që nxjerr atë deklaratë në emër të KK, por edhe në emër të qytetarëve. Të caktohen 3-4 veta që kanë njohur në këtë lëmi, gjegjësisht në nxjerrjen e këtyre deklaratave edhe t’ia jap fuqinë Kuvendi. Kryesuesi i AK-së të përfaqësoj në atë komision dhe disa të tjerë që caktohen, gjuhëtarë, Bedriu, nga ekzekutivi, Fadili ose Arbeni etj. Të bëhet një komision dhe në t’ia japim fuqinë. Dihet se çka duhet kërkuar si AK thjesht një mbështetje morale për një figurë që unë mendoj është emblematike jo vetëm e Klinës por e mbarë Kosovës. Njeri që kemi marrë shumë prej tij sidomos në krijimin e Klimës ndërpolitike. Nëse është ndokujtr që i referohem pikërisht atij edhe është mirë në këtë frymë për ta nxjerrë”, ka konstatuar Kryetari Bashota. .

Tunë Dedaj, tha se e përkrahi iniciativë e Kryetarit edhe në atë grup nga AAK kisha propozuar Pal Berishën.

Fadil Gashi, tha se e para unë po ju falënderoj të gjithë, unë po dua ta zhvesh prej petkut politik dhe petkut të LDK-së, sepse ai ka qenë Kryetar i Komunës. “E dyta, vazhdoi anëtari Gashi, nuk na merr aq kohë, sepse ne nuk kemi shumë të bëjmë, unë e thashë në fjalën time. Në detaje nuk mund të lëshohem, as nuk mund të kërkojmë detaje, ne në vija të trasha dhe po shpresoj se krejt 2-3 çështje dalin. Unë po ashtu edhe shefat e grupeve, ashtu siç e tha edhe Kryetari, e para është ne ta shprehim shqetësimin tonë për mos zbardhjen e rastit dhe kjo nuk do aq kohë të madhe sa për ta shprehur shqetësimin e këtij institucioni tonë për kohën sa ka zgjatur dhe nuk kemi asnjë sinjal. E dyta është për të kërkuar nga organet tona, kërkesë tash del, të paktën, nuk është fjala as mua në këtë rast si kryetar i Degës, as këtë Kuvend, port ë paktën ju si Kryesues, Kryetarin si institucion, le të njoftojnë a janë duke zhvilluar apo nuk janë duke zhvilluar hetime; a i kanë ndaluar krejt apo i kanë humbur krejt. Le të komunikojnë me ju organet, ne po kërkojmë komunikim zyrtar jo si parti as si individ por si Kuvend, si institucion, domethënë krejt brumi është ky”, theksoi anëtari Gashi.

Halil Desku, tha se jam në favor të kësaj deklarate, kjo mund të kryhet sot dhe pa komplikime. “Nuk do të thotë që në atë komision duhet për të qenë shefat, por mund të jenë edhe të ekzekutivit edhe njohës të një lëmie, domethënë të shkrimit, dhe pastaj e sjellim këtu për miratim”, theksoi prof. Desku.

Haxhi Ibishi, shefat e GP, bashkë me Alinë edhe me Bedriun në zyrën time e përpiloni deklaratën dhe të na sillni në seancë.

Avni Gashi, theksoi që ne si GP që kemi qenë jemi ndarë tash, po vërej që po diskutohet. “Nuk kam dëshirë të ndihem në këso pozitash, asnjëherë nuk e kemi ngritur çështjen e profesor Ndout që është vetëm dy vetë dhe ka vepruar në kuadër të GP edhe në KPF. Ne jemi ndarë për shkak të lëvizjes së Petritit. Përndryshe jemi GP dhe vazhdojmë të mbesim ashtu, sepse është krijuar fillimisht prej kësaj asambleje. Dhe nuk kam dëshirë për t’u gjendur në pozitë a është apo nuk është 3- apo 4. Edhe sot ndarja pa u diskutuar, vërtetë po na qitni në pozita të këqija, sidomos në këto raste të flasim për këto”, theksoi anëtar i Gashi.

Ndue Shabanaj, tha se derisa GP janë formuar ato ekzistojnë. “Duhet një vendim tjetër për t’u rasformuar ato për të mos ekzistuar. “Derisa këto ekzistojnë duhet për t’u respektuar. Dhe unë nuk jam as me dhunë, as pa dhunë, as me të mirë, as me të keq, por jam për t’u respektuar ajo çka është. Ajo që nuk është nuk respektohet edhe kjo është një çështje krejtësisht e qartë”, tha prof. Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se ekziston edhe Grupi 3 plus krahas Grupit IPK.

Ndue Shabanaj, theksoi se këtu nuk rrimë për hatër të askujt, mirëpo qëndrojmë për aq sa jemi të thirrur për të qëndruar.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Organizatave të Veteranëve të Luftës me mbulim të shpenzimeve janar – prill 2016.

Haxhi Ibishi, theksoi se në KPF e kemi marrë një shkresë prej OVL, ka qenë një dakordancë e të gjithëve që ajo për t’u debatuar këtu. “Drejtori atëherë na ka thënë që mundësitë buxhetore janë të kufizuara, por në konsultim edhe më Kryetarin e kemi vendosur si pikë të rendit të ditës, për të parë bashkërisht se çfarë mund të bëhet në këtë drejtim. Kërkesa është ajo që u është dërguar edhe juve me kohë, e keni marrë me kohë, prandaj edhe hapi diskutimin”, theksoi kryesuesi Dr. Ibishi.

Sokol Bashota, theksoi se unë vetëm dua t’ju jap një sqarim të vogël: “Unë Brenda mundësive buxhetore si Kryetar i Komunës, në mënyrë të vazhdueshme i kam mbështetur këto organizata për shkak të punës që kanë bërë ata në terren duke mbledhur informacione dhe material të ndryshme, por edhe duke organizuar qoftë përvjetorë dhe manifestime të tjera kombëtare deri në momentin kur ata nuk kanë pasur asnjë mbështetje institucionale, përkatësisht ndonjë benefit prej Qeverisë së Kosovës siç kanë tani. Tash bëhet fjalë për punën dhe angazhimin e tri shoqatave, përkatësisht të kryesisë së tri shoqatave dhe e dini qysh na ndodhi për ato 50 mijë euro që nuk mundem për t’i destinuar qartë për sport dhe 15 mijë euro që më janë ulur subvensionet, edhe ndarja tash edhe për bursat e studentëve, edhe për sportin, edhe për festivalin, edhe për manifestimet tjera “Ora e Tahir Deskut” dhe një aktivitet të të zhdukurve, unë mendoj që është shumë e papërballueshme për bërë ndonjë zgjidhje të duhur dhe adekuate. Do ndarje votohet në asamble, buxheti ynë e tha edhe drejtori i Financave është nga realizimi i të hyrave dhe ne ndoshta do të kemi hendikep për të mundur për të realizuar të hyrat për shkak të rritjes që kemi 1 28 000 euro, unë mendoj që do të ishte mirë për t’ia dhënë një miratim apo mbështetje me mundësi buxhetore, dhe e shikoni si mundësi”, vlerësoi Kryetari Bashota.

Skënder Merturi, tha se e dëgjova me vëmendje fjalën e Kryetarit, por është e arsyeshme mbështetja edhe pse e di që janë mbështetur edhe më herët shoqatat. “Por, ka ardhur një arsyetim i mirë prej tri organizatave dhe po dua të besoj dhe të mendoj që ne të gjithë këtu që jemi prezent e kemi vullnetin për t’u ndihmuar këto organizata, edhe pse ndoshta nuk e bëjnë punën më të mirë të mundshme, por po bëjnë do punë edhe kisha kërkuar prej Kryetarit në këtë rast, që le të shqyrton mirë gjitha mundësitë, edhe drejtori i Financave, edhe kësaj radhe të përkrahen edhe të mbështeten këto tri organizata për punën që e bëjnë. Herëve të tjera ata le të kenë pak ma me kujdes edhe ta bëjnë një plan tek e fundit ndoshta edhe vjetor që në fund të vitit ose kur të bëhet miratimi i buxhetit të na vijë një kërkesë prej tyre që brenda vitit sa kanë ata kërkesa edhe kur të votohet buxheti të shqyrtohet mundësia dhe të jetë një mundësi edhe për ne si Asamble, edhe për Kryetarin e Komunës,

të jetë më e mirë që të përkrahen dhe të mbështeten këto organizata në të ardhmen nëse kanë nevojë për mbështetje, e lokale, këtu në Klinë”, ka theksuar anëtari Merturi.

Sokol Bashota, tha se këto kategori, përkatësisht kryetarët e këtyre shoqatave, nuk kanë asnjë mbështetje financiare nga asnjë organizëm tjetër. “Nuk kam ndonjë informacion detal. Por e shoh që vazhdimisht dalin në zyrat e tyre edhe dalin në terren. I përpilojnë ato shënimet për nevojat e tyre që i kanë dhe mendoj që nuk jam për të mos i mbështetur, vetëm është mirë për ta lënë si mundësi buxhetore në mënyrë që kur ta marrim vendimin detyrohemi detyrimisht dhe formë tjetër përpos subvencioneve nuk kemi asnjë mënyrë tjetër për t’i kompensuar, nga kapitalet nuk ka mundësi, nga mallra e shërbime nuk mund t’i marrim, vetëm nga subvencionet dhe nuk mundesh për t’i ikur një vendimi të asamblesë që janë ndarë 20 000 euro për festivalin, 20 000 euro për KF “Dukagjini”, 7 mijë euro për klubet tjera të femrave, 10 000 për bursa. Po them le të lihet si mundësi buxhetor, shumë është diku 960 euro, nuk është ndonjë shumë e madhe, por të lihet si mundësi”, theksoi Kryetari.

Fadil Gashi, theksoi se kërkesën e kemi për këta tre muaj, por çfarë do të bëjmë për të ardhmen. “A ka bazë ligjore për t’ju paguat për t’ju paguar udhëtimin. Ka edhe shoqata tjera. Baza ligjore dhe mundësitë buxhetore dallojnë. Sa ju ndihmon qendra nuk e di, shikoni bazën ligjore dhe a mund t’i dalim në fund”, shtoi anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se kanë për të na pasuar edhe kërkesa të tjera. “Nuk është e nevojshme që kjo gjithëherë të mbështetet. 9 mijë euro nuk është shumë e madhe, me mundësi buxhetore të vlerësohet kështu”, tha Kryetari.

Ramiz Rrusta, sqaroi se është duke u punuar një rregullore se si do të bëhet ndarja e subvencioneve. “Ne ju kemi dalë në ndihmë gjithëherë. Mënyrën e pagesës do ta kemi shumë të vështirë. Duhet të kemi kujdes”, shtoi drejtori Rrusta.

Sokol Bashota, sqaroi çështjen tematike. “Komuna në ngjarjet kombëtare gjithëherë i ka mbështetur. Fjala është për shpenzimet e punës dhe detyrave të punës që kryejnë. Jam për të ndihmuar në mënyrë modestë”, pohoi Kryetari.

Kristinë Lazri, foli rreth çështjes. “Më ka rënë të lexojë Rregulloren për subvencione. Deri në 2 mijë euro ka të drejtë për të subvencionuar, mbi këtë shumë vendimin e merr Kuvendi i Komunës”, sqaroi drejtoresha Lazri.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në debat. “Është mirë për ta kthyer në një analizë”, pohoi Dr. Ibishi.

Skënder Merturi, tha se është mirë ta votojmë, me mundësi. “Kryetari le të këqyr, të ndihmohen në mënyrë simbolike. Të kemi kujdes. Këto tri shoqata marrin edhe nga niveli qendror. Në si Asamble komunale t’u përgjigjemi pozitivisht, ndërkaq edhe ata le të jenë të kujdesshëm”, tha anëtari Merturi.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes tematike.

Fadil Gashi, theksoi të mos marrim një vendim që s’mund ta implementojmë. “Po që se Kryetari ka mundësi le të veprojë brenda rregullores”, tha anëtari Gashi.

Sokol Bashota, theksoi se e kam adresuar se kjo shifër tejkalon limitin e mundësive të mia. “Ne ju kemi ndihmuar edhe në të kaluarën. Rregullorja lejon deri në 2 mijë euro, s’lejon mundësi më shumë. Po i shikoj mundësitë që brenda rregullores për t’i mbështetur”, tha Kryetari Bashota.

Pika e shtatë: Aprovimi i Deklaratës së Kuvendit të Komunës rreth vrasjes ish- Kryetarit të Komunës, Ismet Rraci.

Kryesuesi, Dr. Haxhi Ibishi lexoi deklaratën. Deklarata ka këtë përmbajtje:

“Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e rregullt, të mbajtur më datën 29 prill 2016, lëshon këtë: DEKLARATË. Kuvendi i Komunës së Klinës, me rastin e 15-vjetorit të vrasjes së Ismet Rracit, ish-kryetarit të parë të Komunës, i zgjedhur me votën e lirë të qytetarëve, në mënyrë unanime, shpreh indinjatë për moszbardhjen rasti të vrasjes dhe gjetjes së kryerësve të këtij rasti makabër. Kuvendi kërkon informacion të plotë se deri ku ka arritur procesi i hetimit dhe ndriçimit të këtij rasti. Kuvendi i Komunës së Klinës kërkon nga organet përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha veprimet përkatëse për ndriçimin sa më të shpejtë, sjelljen para drejtësisë dhe dënimin merititor të fajtorëve. Kuvendi i Komunës, në emër të qytetarëve të Klinës, kërkon që përgjegjësia institucionale dhe qytetare e organeve të drejtësisë të shpreh efikasitetin në funksion të sundimit të ligjit në Kosovë”, thuhet në deklaratën e dt. 29 prill 2016, të nënshkruar nga Kryesuesi, Dr. Haxhi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim deklaratën.

Me vota unanime (21), u miratua Deklarata.

Pika e tetë: Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Hapi debatin.

Skënder Merturi, tha se na shqetëson mosprezenca e drejtorëve të ekzekutivit. “Kam dy pyetje: E para për drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe për drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport. A do të kishte pasur mundësi drejtori i Shëndetësisë të na sqarojë rreth konkursit të fundit në QKMF? E dyta, për drejtoreshën e Kulturës, pse që tre muaj nuk janë paguar lojtarët e KF “Dukagjini, kur ne veç dihet i kemi ndarë mjetet për këtë klub”?- prezantoi interesimin anëtari Merturi.

Vlora Tafili, pyeti se pse Komuna e Klinës nuk qendër për të hulumtuar dhe për të marrë statistika për banorët që kanë nevojë për strehim social. “Si Komunë kemi qendrën për ndihmë sociale, por jo për atë për strehim social dhe kjo do të thotë që kjo kategori komplet është e anashkaluar nga Komuna e Klinës. Dhe vlen për të cekur kah ka dalë tash lista për përfitimin e banesave sociale. Dy përgjigje i pres për seancën e ardhshme. Tash e kemi rastin e Enver Berishës, këtu po shihet se ka qenë komplet politik, më tepër nuk po flasim, pres përgjigjet në seancën e ardhshme”, tha anëtarja Tafili.

Enver Gashi, tha se kam 2 pyetje që po i ripërsëris, sepse i kam bërë më herët, mirë përgjigjet asnjë herë nuk i kam marrë, pres që në seancën e ardhshme t’i marr përgjigjet. “Në komunën tonë kemi tri shkolla që janë pilot-projekt, domethënë me kurrikul të re, pyetja e parë kur do të hynë shkollat tjera në kurrikul, dhe pyetja e dytë, KK e ka miratuar rregulloren për masa disiplinore dhe kodin e mirësjelljes në të gjitha institucionet, orët e kujdestarisë kur do të hyjnë dhe a do të paguhen kur dihet se në kodin e mirësjelljes janë edhe orët e kujdestarisë?”-pyeti anëtari.

Petrit Palushi, adresoi pyetjen për drejtorin e Shëndetësisë: “Kush e hap kutinë e ankesave?”- pyeti ai.

Lorenc Merleku, tha se opozita ishte dashur që të ketë hapësirë më shumë për të debatuar.

Bedri Gashi, iu përgjigj pyetjes së anëtarit Palushi.

Bozhidar Sharkoviq, paraqiti interesimin rreth një sulmi që i është bërë një familje të kthyer të komunikimit serb në fshatin Rudicë, ku është gjuajtur edhe me armë zjarri. “Nuk di policia deri ku ka arritur me rastin. Ngjarja ka shqetësuar familjen e cila tash parasheh që të kthehet”, shoti anëtari Sharkoviq, i cili në vijim paraqiti shqetësimin rreth varrezave të komunitetit serb në Klinë, po ashtu edhe të mbeturinave në Dolle dhe në fshatin Drenoc ku sipas tij po krijohen probleme në pronësi.

Haxhi Ibishi, iu përgjigj anëtarit Sharkoviq.

Seanca përfundoi në orën 13.45 minuta.

Mikel GOJANI

Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI

